



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në zbatim të nenit 22 dhe 25 të Ligjit Nr.152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM nr. 243 datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” Këshilli i Qarkut Shkodër shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

**Specialist në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e
Qarkut Shkoder**

Kategoria e pages: IV3

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil .

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NE SHERBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për: LËVIZJE PARALELE	19 Tetor 2025
Afati për dorëzimin e dokumentave për: PRANIM NE SHERBIMIN CIVIL	24 Tetor 2025

Pershkrimi i Pergjithshem i punes per pozicionin eshte:

- Zbatimi i detyrave specifike, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore organike në fuqi. Ndjekja dhe zbatimi i të gjitha detyrave të caktuara nga organet vendimarrëse dhe të Këshillit të Qarkut, dhe Titullari i Institucionit.
- Evidenton dhe miremban dokumentacionin kadastral të pronësive private apo shtetërore (publike), të periudhës para ose pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.108, datë 29.8.1945 “Për reformën agrare”, kur këto dokumente janë ruajtur dhe ekzistojnë në arkivin e DAMT-së.
- Mban dhe ruan dokumentacionin kadastral të tokës bujqësore, pamvaresisht nga koha e prodhimit të tyre, që nga 29.8.1945 deri më 19.7.1991.
- Ruan dhe miremban dokumente, që janë objekt fondin e tokës bujqësore dhe të kategorive të resurseve të tjera, në të cilat evidentohen ose pasqyrohen tregues dhe të dhëna për ndryshimet e kalimeve të tokave, si dhe të dokumentacionit të ndarjes së tokës dhe krijimit të titujve të pronësisë mbi të, kur mbajtja dhe ruajtja e këtij dokumentacioni nga DAMT-ja (ish-zyra e kadastrës) është përcaktuar me akte ligjore ose nënligjore
- Perditeson (përditëson) Librat e Ngastrave dhe Librat e Tokës.
- Matje dhe verifikime të ndryshme në terren, me matje të thjeshta e të ndryshme.
- Perditeson hartografinë kadastrale, të shkallëve të ndryshme.
- Harton e përpilon Libra Ngastrash dhe Libra Tokë të reja, shoqëruar me hartografinë përkatëse, për zona me tokë bujqësore, për të cilët merr detyrë nga drejtuesi i DAMT-s.
- Pasqyron në librat përkatës, akte (vendime) të organeve apo strukturave kompetente, të përcaktuara në ligj, nëpërmjet të cilave janë realizuar ndryshime apo kalime të tokës bujqësore në kategori të resurseve të tjera.
- Mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues, që ka për objekt kategoritë e resurseve në juridiksion që mbulon.
- Bashkërendon punën mezyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në njesite e qeverisjes vendore, dhe organizon punën për krijimin e dokumentacionit të ri kadastral për tokën bujqësore dhe kategoritë e resurseve të tjera, të përcaktuara me ligjin organik për DAMT-n.
- Perditeson librat (pasqyrat) e treguesve të studimit të bonitetit të tokave bujqësore dhe të kategorizimit të tokës sipas bonitetit, në bashkëpunim me institucionin kompetent të QTTB Shkoder.
- Mbledh të dhënat e dokumentacionit të ri kadastral, të cilat pasqyrohen në “Regjistrin e tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve”, të miratuar me urdhrin e përbashkët, nr.107, datë 27.3.2009 të Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrisë të Brendshme, dhe pasi i

perpunon, procedohet me dorezimin e tyre në QTTB Shkoder, per kalimin ne sistemin GIS.

- Shqyrton kërkesat e subjekteve të interesuara për ndryshim të kategorive të resurseve të tokës (nen pergjegjesine e specialistit Agronom) dhe bën verifikim për saktësinë e përmbajtjes së tyre dhe, kur i gjen ato në përputhje me dokumentacionin kadastral, të plotësuar me të gjitha elementet përbërëse të përcaktuara të tyre, ia dërgon për shqyrtim dhe miratim MBUMK-së.
- Pranon e shqyrton kërkesa te ndryshme të shtetasve per informacion kadastral, per teritorin qe mbulon, dhe jep informacion në bazë të dokumentacionit që disponon, bazuar ne ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi.

I – LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë :

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv, mirë apo shumë mirë nga punëdhënësi i fundit
-

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë me arsim të lartë, Shkenca Inxhnierike, Agronomi, bazuar në përshkrimin e punës dhe detyrat funksionale
- Të ketë eksperiencë dhe përvojë pune, të paktën 5 vite
- Të ketë njohuri të mira në programet bazë të kompjuterit
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, menaxhuese, aftësi dalluese në punën në grup
- Të mos jenë marrë masa disiplinore te parashikura në Ligjin Nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Shkoder, brënda datës se shpallur ne njoftim si më poshtë:

1. Kerkese me shkrim per aplikim (leter motivimi)
2. Curriculum Vitae (Jeteshkrim standart, Europass)
3. <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>
4. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.

5. Fotokopje te kartës së Identitetit.
6. Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e notërizuar) nese ka.
7. Aktin e statusit të nëpunësit Civil
8. Vleresim pune nga punëdhënësi i fundit.
9. Vertetim që nuk kanë masë administrative në fuqi
10. Dëshmi i gjendjes gjyqësore (Deshmi Penale),
11. Raport mjeko –ligjor nga komisioni mjekesor kompetent i aftë për punë
12. Fotokopjo të Librezës së punës të të gjitha rubrikave të plotësuar.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Duke filluar me perfundimin dates te shpallur ne njoftim Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Shkoder, do të shpallë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga kjo zyrë, nëpërmjet email- it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin.
- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë e tyre mbi :

- Kushtetuta Republikës së Shqipërisë
- Ligji 152/2013 “Për nënpunësin Civil”
- Ligji Nr.8652 datë 31.07.2000, “Për Organizimin e Funksionimin e Qeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.7961,datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë
- Ligji Nr.9367 datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”
- Ligji Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Rregullat e Etikës në Administratën Publike
- Ligji nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar.
- VKM nr.121, date 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”
- Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave për organet e pushtetit vendor.

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve për lëvizjen paralele

Kandidatët do të vlerësohen me pikë sipas skemës së vlerësimit si më poshtë:

- **40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar** (20 pikë – përvoja 10 pikë – trajnimet ose kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse ; 10 pikë – vlerësimet e rezultateve individuale në punë).
- **60 pikë nga intervista e strukturuar me gojë.**
Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Shkoder do të shpallë fituesin në portalin Agjensia Kombetare e Punësimit dhe Aftësive, Faqen Zyrtare të Këshillit të Qarkut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike

II - PRANIMI NË SHËRBIMI CIVIL

Vetëm në rast të përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant ,ky pozicion është i vlefshëm për procedurën e pranimi në shërbimin civil nëpërmjet një konkurrimi të hapur.

2.1 Kushtet qe duhet te plotesojë kandidati ne proceduren e pranimi në shërbimin civil dhe kriteret e vecanta.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kërkesat e posaçme:

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë I dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojë diplomë Universiteti, Shkenca Inxhnierike, Agronomi, Diploma e nivelit Master eshte avantazh ne procesin e konkurimit
- b- Të kenë mbi 5 (vite) vjet përvojë pune.
- c- Të kenë njohuri shumë të mira të akteve ligjore dhe nënligjore në të cilat përcaktohet organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.
- d- Aftësi për të ofruar kompetence teknike, për të koordinuar, zhvilluar dhe administruar dokumentacionet perkatese.
- e- Të përvetësojë praktikisht, programet bazike “AutoCAD Map”, “Microsoft Excel” dhe “Microsoft Word”, si domosdoshmeri e punës së përditshme për sektorin e administrimit të tokës. Ky kriter do të testohet dhe vlerësohet në

fazën e testimit me shkrim, në përpunimin e një teritori disa hektarësh tokë bujqësore, në diçitalizim hartografik të zones të përcaktuar si dhe përpilimin e Librit të Ngastrave përkatës.

f- Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze, si dhe një gjuhë tjetër të B.E.

2.2 DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATI I DOREZIMIT

Kandidatet që do të aplikojnë duhet të dorezojnë dokumentat si me poshte:

- Jeteshkrim Standart (CV . jeteshkrim standart)
- <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-standard>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor), (nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, duhet ta ketë të njësuar pranë Ministrisë së Arsimit);
- Fotokopje e listës së notave (nëse ka një listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorezimi i dokumentave për procedurën e pranimit në shërbimin civil do të bëhet brenda datës së shpallur në njoftim, pranë Zyres së Burimeve Njerezore në Institucionin e Këshillit të Qarkut Shkoder.

2.3 REZULTATET PËR FAZEN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar me përfundimin e datës të shpallur në njoftim Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore në Këshillin e Qarkut Shkoder do të shpallë në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare dhe në stendin e informimit të publikut, listën e kandidateve, që plotësojnë kushtet dhe kriteret e vecanta për procedurën e pranimit në shërbimin civil, vendin, datën dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatet që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret e vecanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga sektori i burimeve njerezore, për shkak të moskualifikimit.

2.4 Fushat e njohurive, aftesite dhe cilesite mbi te cilat do te zhvillohet testimi dhe intervista.

Kandidatet do te testohen me shkrim ne lidhje me:

- Kushtetuta Republikës së Shqipërisë
- Ligji 152/2013 “Për nënpunësin Civil”
- Ligji Nr.8652 datë 31.07.2000, “Për Organizimin e Funksionimin e Qeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr.9367 datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”
- Ligji Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Rregullat e Etikës në Administratën Publike
- Ligji nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar.
- VKM nr.121, date 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”
- Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave për organet e pushtetit vendor.
- Përpunimin kadastral të një teritori prej 70 hektarësh tokë bujqësore, në digitalizimin hartografik të zonës të paracaktuar, si dhe përpilimin e Librit të Ngastrave përkatës.

Kandidatet gjate intervistes se strukturuar me goje do te vleresohen ne lidhje me:

- Njohuritë, aftesitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës,
- Eksperiencën e tyre të mëparshme,
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 Menyra e vleresimit në lidhje me:

- Vlerësimi me shkrim, deri në 40 pike;
- Intervistën e strukturuar me gojë deri në 40 pike
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të parës së trajnimeve, të lidhura me fushën, deri 20 pike.

2.6 Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe menyra e komunikimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Qarkut Shkoder do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nepermjet adresës së e-mail, apo nr.telefonit*) Burimet Njerëzore do të njoftojnë fituesin në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” në faqen zyrtare dhe në stenden e informimit të publikut.